

ISSN: 3006-8592
E-ISSN: 3006-8606

kyriias

NUMËR 3, 2025

REVISTË PERIODIKE SHKENCORE-INFORMATIVE

BOTIM I KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"



ALBANIAN TOURISM ASSOCIATION
SHOQATA SHQIPTARE E TURIZMIT



QIRIAZI
UNIVERSITY
COLLEGE



INTERNATIONAL CONFERENCE ON TOURISM AND HOSPITALITY

Kolegji Universitar Qiriazi
Qiriazi University College
(30 May 2024)
Tirana, Albania

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE MBI TURIZMIN DHE HOTELERINË

Conference Proceedings Book
Libri i Punimeve të Konferencës



KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

kyrias

NR 3, 2025 "REVISTË PERIODIKE SHKENCORE-INFORMATIVE".
BOTIM I KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"

KYRIAS- Është një revistë shumëdisiplinare shkencore-informative e Kolegjit Universitar Qiriazi.
KYRIAS është revistë dygjuhëshe (shqip dhe anglisht) dhe publikohet çdo gjashtëmuor.
Kjo revistë është një burim informacioni me qasje të hapur.

© KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI – TIRANË, SHQIPËRI

This is a multidisciplinary scientific-informative journal of Qiriazi University College.
KYRIAS is a bilingual (Albanian and English) journal, and is published semi-annually.
This Journal is an Open Access source of information.

© Published by: QIRIAZI UNIVERSITY COLLEGE – TIRANA, ALBANIA

kyrias@qiriaz.edu.al
+355 672070313

Çmimi/ Price 500 ALL

Kryeredaktori: / Editor-in-Chief: Dr. Gjovalin Gjeloši

Redaktor: / Editor: Valbona Asani

Conference Organizing Committee / Komiteti Organizativ i Konferencës

Viliem Kurtulaj, PhD	Qiriazi University College
Assoc. Prof. Abdullah Beram	Kutbilge Association of Academics
Prof. Dr. Halit Xhafa	Qiriazi University College
Prof. Asc. Dr. Arif Atak	Bursa Uludağ University
Zak Topuzi	Albanian Tourism Association
Msc. Anxhela Uldedaj	Kolegji Universitar Qiriazi

Bordi Editorial: / Editorial Board:

Prof. Dr. Hamit Boriçi, Albanian University, Tiranë
Akademik, Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaç Akademia e Shkencave e RSH
Prof. Dr. Abdyl Sinani, Kolegji Universitar Qiriazi
Prof. Dr. Vejsel Rizvanolli, Kolegji Universitar Qiriazi
Prof. Asc. Dr. Pashk Lekaj, Kolegji Universitar Qiriazi
Prof. Asc. Dr. Arif Atak, Bursa Uludağ University

Komiteti Shkencor: / Scientific Committee:

Prof. Dr. Halit Xhafa, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Prof. Dr. Ylli Zhurda, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë,
Prof. Dr. Dr. Basil Schader, Shkolla e Lartë Pedagogjike, Zyrih, Zvicër
Prof. Asc. Dr. Arif Atak, Bursa Uludağ University, Bursa, Turqi
Prof. Dr. Skender Asani, ITKSHSH, Shkup, Maqedonia e Veriut.
Dr. Mark Camaj, Universiteti Shtetëror Nikshiq, Mali i Zi
Prof. Asc. Dr. Enida Bozheku, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Gurakuç Kuçi, Instituti i Sigurisë “Oktapod”, Prishtinë, Kosovë
Prof. Dr. Arben Verçuni, Universiteti Bujqësor i Tiranës
Dr. Meri Kraja, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Elsa Haxha, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Valentina Memini, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Ida Kruti, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Erjona Fusha, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Prof. Asc. Dr. Besim Beqaj, Universiteti i Prishtinës, Kosovë
Dr. Altin Kulli, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë
Dr. Sadri Ramabaja, Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë, Prishtinë, Kosovë
Dr. Gjovalin Gjeloši, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë.

Design: Hekuran Koka

TIRANË/TIRANA, 2025





Përmbajtja

Përgatitja e Burimeve
Njerëzore për të shërbyer në
turizëm- ndër sfidat kryesore
Prof. Dr. Gjokë Ulledaj 6

Turizmi në Shqipëri dhe
Perspektiva 2030

Zak Topuzi 9

The importance of agro-
tourism and horti-tourism in
new tourism strategies
Prof. Asc. Dr. Arif ATAK 12

Efektet e politikave
mbështetëse në rritjen e
partneritetit të fermerëve me
tregjet

Prof. Dr. Maksim Meço, Dr.
Gjovalin Gjeloşi, Dr. Altin
Kulli 17

Udhërrëfyesi turistik si
promotor i historisë e kulturës
dhe si menaxher i aseteve
njerëzore

Dr. Edlir ORHANI
Prof. Dr. Gjokë ULDEDAJ 24



Analiza e legjislacionit turistik në Shqipëri: Sfidat dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit turistik Dr. Valentina Memini	33	Vetitë reologjike të disa kultivarëve gruri me përmbajtje të ndryshme amilazë Prof. Dr. Abdyl Sinani, Msc. Mirvjen Shehaj	80
Turizëmi i qëndrueshëm dhe objektivat e agjendës 2030 Dr. Meri Kraja, Dr. Gerta Gjeta, Mariafiona Gjeçi	42	Circular Economy and Tourism Linkage towards a Sustainable Economy (abstract) Altin Kulli, Nelson Duarte, Edlir Orhani, Marsela Resulaj	89
Kapitali Social dhe Turizmi Dr. Erjona Fusha, Geltijana Serjanaj	52	A Mixed Bag of Scenic Beauty and Frustration Msc. Jiaying Luo	90
Ekonomia informale dhe ndikimi i administrimit e i sistemit tatimor, në uljen evazionit fiscal Prof. Dr. Halit Xhafa, Prof. Dr. Agim Binaj	57	Përdorimi i Platformës Online si Metodologji në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze, në Kontekstin Akademik Shqiptar Dr. Eda Cauli, Msc. Arjela Pepa	92
Siguria ushqimore-komponent thelbësor për zhvillimin e agroturizmit Dr. Gjovalin Gjeloşi, Ambra Mema, Fridion Ndoj	63	Titulli “Doctor Honoris Causa” për Prof. Dr. Enver Hoxhaj Promovim librash në Kolegjin Universitar “Qiriazi” Tryezë mes universiteteve shqiptare dhe italiane	96 99 100
Jeta kulturore e turistike në qytetet e mëdha të shqipërisë (1925-1939)” Msc. Gerta Kotka	69	“Drejtësia dhe Zgjerimi i BE” Horizonte të reja akademike 116 vjetori i Alfabetit të Gjuhës Shqipe Partneritet për Edukim dhe Konkurrencë të Ndershme	103 104 105 106



TURIZMI I QËNDRUESHËM DHE OBJEKTIVAT E AGJENDËS 2030

Dr. Meri KRAJA
Departamenti i të Drejtës
Publike dhe Penale
Fakulteti i Drejtësisë,
Kolegji Universitar Qiriazi.

Dr. Gerta GJETA
Fakulteti i Drejtësisë,
Kolegji Universitar Qiriazi .

Mariafiona GJEÇI
Studente, Fakulteti i Drejtësisë,
Kolegji Universitar Qiriazi.

A B S T R A C T

Globalization and the vast transportation network have made travel easier, turning any destination into a potential tourist destination. Sustainable tourism is a new way of traveling and a valuable alternative to classic tourist destinations, which favors the discovery of territories and aims to limit as much as possible the impact on the environment, encouraging direct knowledge of new cultures, traditions, local communities, and naturalistic contexts of high interest. The role of tourism and culture in sustainable development and their transformative power have been widely recognized in recent years and their impact has been assessed and re-evaluated in many ways. The 2030 Agenda, endorsed and strongly supported by the EU, recognizes the active role of tourism in inclusive and sustainable economic growth.

This paper aims to show the situation of Sustainable Development and Planning in the design and implementation of sustainable plans for the development of tourism. What is expected from the 2030 Agenda and the challenges for Albania? What is the challenge for tourism in Albania? It is important to make

tourists and communities aware of sustainable tourism practices and the importance of respecting the country's environment and culture. It is therefore precisely this naturalistic spirit that must be preserved together with the sustainable approach to tourism development according to the objectives of the UN Agenda.

KEY WORDS : Agenda, tourism, management, development strategy, sustainable development.

A B S T R A K T

Globalizimi dhe rrjeti i gjerë i transportit kanë lehtësuar udhëtimin, duke e shndërruar çdo destinacion në një destinacion të mundshëm turistik. Turizmi i qëndrueshëm është një mënyrë e re udhëtimi dhe një alternativë e vlefshme për destinacionet klasike turistike, e cila favorizon zbulimin e territoreve dhe synon të kufizojë sa më shumë ndikimin në mjedis, duke inkurajuar njohjen e drejtpërdrejtë të kulturave të reja, traditave, komuniteteve lokale dhe kontekste natyraliste me interes të madh. Roli i turizmit dhe i kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm dhe fuqia e tyre transformuese janë njohur gjerësisht



gjatë viteve të fundit dhe ndikimi i tyre është vlerësuar dhe rivlerësuar në shumë mënyra. Agjenda 2030, e miratuar dhe e mbështetur fuqishëm nga BE-ja, njeh rolin aktiv të turizmit në rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Qëllimi i këtij punimi është të tregojë se si është situata e Zhvillimit dhe Planifikimit të Qëndrueshëm në hartimin dhe zbatimin e planeve të qëndrueshme për zhvillimin e turizmit. Çfarë pritet nga Agjenda 2030 dhe sfidat për Shqipërinë? Cila është sfida për turizmin në Shqipëri? Është e rëndësishme të ndërjegjësohen turistët dhe komunitetet për praktikën e qëndrueshme turistike, si dhe për rëndësinë e respektimit të mjedisit dhe kulturës së vendit. Është pra pikërisht ky shpirt natyralist që duhet ruajtur së bashku me qasjen e qëndrueshme të zhvillimit të turizmit sipas objektivave të Agjendës së OKB-së.

F J A L Ë T K Y Ç E : Agjendë, turizëm, menaxhim, strategji zhvillimi, zhvillim i qëndrueshëm.

Hyrje

Gjatë dekadës së fundit, qytete të shumta dhe peizazhe natyrore, në çdo cep të planetit, kanë përjetuar transformime të thella të lidhura me turizmin. Ndotja dhe konsumimi i tokës me vepra dhe infrastrukturë të padobishme për turistët, dëbimi i banorëve të varfër dhe aktivitetet historike tregtare, shpopullimi dhe shkretëtirëzimi i qendrave historike, janë vetëm disa nga këto probleme. Qofshin qytete arti, parajsa natyrore, fshatra kodrinore apo zona të vogla arkeologjike, turizmi masiv shkakton një proces që modifikon ekosistemin urban dhe natyror, duke konsumuar dhe shpesh duke fshirë karakteristikat që qëndrojnë në themel të atraktivitetit të destinacioneve turistike¹.

Por, a mund të mendohet për turizëm të qëndrueshëm për territoret dhe popullsinë vendase, pa shtrembëruar vendet ku kalojmë pushimet? Për të përshkruar zhvillimin e turizmit si dhe të turizmi masiv, duhet të marrim në konsideratë rolin i tij në zhvillimin e

ekonomisë, politikave urbanistike dhe kulturore në këtë proces, për të treguar kontradiktat e një sektori që ka një ndikim të madh, por që në të njëjtën kohë shpesh ka pasoja shkatërruese për territoret. Që kjo të mos ndodhë më, është e nevojshme të rimendohet turizmi duke u nisur nga një këndvështrim i ri, nga një “ekologji popullore”.

Turizmi ndjek logjikën e procesit të nxjerrjes së karburanteve fosile, me pak fjalë: zbulim, hipershfrytëzim, rraskapitje, ndotje dhe shkretëtirë. Përtej retorikës sterile të qëndrueshmërisë (greenwashing), të dy fenomenet pasqyrojnë plotësisht logjikën e akumulimit kapitalist që përshkon çdo fushë të jetës tokësore dhe që ka gëlltitur çdo parim të dobisë njerëzore dhe jo njerëzore të një ekonomie tashmë të paqëndrueshme, të cilat shpesh duhet të mbahen gjallë në kurriz të komunitetit, me paratë publike duke përjashtuar dogmat e tregut. Kur turizmi nuk menaxhohet, ose menaxhohet vetëm me synimin për të maksimizuar fitimet në afat të shkurtër, në afat të gjatë kostot e socializuara përfundojnë duke tejkaluar përfitimet. Prandaj, asnjë turizëm i qëndrueshëm nuk është vërtet i zbatueshëm brenda një modeli ekonomik të paqëndrueshëm.

Megjithatë, roli i turizmit dhe i kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm dhe fuqia e tyre transformuese janë njohur gjerësisht gjatë viteve të fundit dhe ndikimi i tyre është vlerësuar dhe rivlerësuar në shumë mënyra. Modeli aktual i turizmit, i cili është dëshmuar të jetë konsumator dhe jo shumë i përgjegjshëm, është inkurajuar të ndryshohet dhe promovohet si një turizëm i qëndrueshëm nga Agjenda 2030 dhe Deklarata e Berlinit².

Agjenda 2030 e identifikon turizmin si një nxitje parësore për rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse që synon komunitetet lokale. Aktivitetet që lidhen me sektorin e turizmit në fakt mund të mbështesin dhe përshpejtojnë tranzicionin e gjelbër duke adoptuar modele të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit. Viti 2015 ka qenë një moment historik për zhvillimin global pasi qeveritë kanë miratuar Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, së bashku me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

¹ Sarah Gainsforth, *Oltre il turismo. Esiste un turismo sostenibile?* Eris, 2020.

² Konferenca e Berlinit “*Trasformare il turismo*”, Berlin, Mars 2017.



(SDGs). Një nga shtetet e para që nënshkroi agjendën ishte dhe Shqipëria, angazhimi dhe përfshirja e saj u shprehen edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020, si dhe përfshirjen në dokumente të tjera kombëtare³. Duke u mbështetur në Objektivat historike të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), grupi ambicioz i 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe 169 objektivave të bashkëlidhur, janë të përqendruar tek njerëzit: transformimi, universalizmi dhe integrimi. Turizmi mund të luajë një rol të madh në arritjen e SDG-ve dhe Turizmi i OKB-së është i përkushtuar t'i sigurojë komunitetit global të turizmit një hapësirë për t'u bashkuar dhe për të realizuar Agjendën 2030.

Sipas agjencisë së Kombeve të Bashkuara, ky është turizmi që është i vetëdijshëm për ndikimin e tij social, ekonomik dhe mjedisor aktual dhe të ardhshëm, i aftë për të kënaqur nevojat e vizitorëve, komuniteteve lokale, mjedisit dhe kompanive. Titulli «Transformimi i botës sonë» hedh poshtë qartë idenë e një qasjeje pasive të biznesit si zakonisht.

Megjithatë, arritja e kësaj Agjende kërkon një kornizë të qartë zbatimi, financim dhe investim adekuat në teknologji, infrastrukturë dhe burime njerëzore⁴. Studimet e fundit nga Organizata Botërore e Turizmit (UNWTO)⁵ nënvizojnë, se si turizmi mund të kontribuojë, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, në arritjen e të 17 objektivave, nëse menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme dhe praktikohet me përgjegjësi⁶. Agjenda 2030 përfaqëson një sfidë ambicioze për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë e pashmangshme, duke vënë në pikëpyetje dimensionet e ndryshme të zhvillimit dhe pabarazitë strukturore, në nivelin ekonomik, social dhe mjedisor të rajonit. Tanimë, nuk ka asnjë dyshim që turizmi po hyn në kryefjalën e zhvillimit ekonomik, social dhe kombëtar të vendit tonë. Prandaj, duke u nisur nga literatura e zhvillimit të turizmit, ne përpiqemi të adresojmë pyetjet e mëposhtme: Çfarë pritet nga Agjenda 2030? A janë 17 Objektivat e

Zhvillimit të Qëndrueshëm, mjaftueshëm ambicioz? Cili është procesi i zhvillimit të turizmit në Shqipëri? A është Shqipëria gati të ofrojë turizëm të qëndrueshëm? Si perceptohet zhvillimi i turizmit dhe situata aktuale në Shqipëri? Shqipëria, me peizazhin e mrekullueshëm natyror, ofron një potencial të jashtëzakonshëm për turizëm të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të shqyrtojmë se si Shqipëria mund të përfitojë nga ky potencial në mënyrë të qëndrueshme dhe të pajtueshme me nevojat e mjedisit dhe shoqërisë.

Përcaktimi i qëndrueshmërisë dhe zhvillimi i turizmit

Termi “i qëndrueshëm” shpesh lidhet veçanërisht me shqetësimet mjedisore, sepse është një term që përdoret kur flasim për zgjidhje të krizës klimatike, por jo vetëm. Por në kontekstin e turizmit, qëndrueshmëria nuk ka të bëjë vetëm me natyrën dhe jetën e egër. Ai përfshin gjithashtu njerëzit, kulturën dhe çështjet sociale. Prandaj, përgjegjësia ndahet midis autoriteteve, operatorëve turistikë, turistëve dhe komuniteteve lokale në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe krijimin e destinacioneve që janë vende më të mira për njerëzit për të jetuar dhe për udhëtarët që t'i vizitojnë, duke siguruar përfitime ekonomike për komunitetet lokale dhe akses në burime, duke përmirësuar kulturën lokale, traditat dhe peizazhet. Qëndrueshmëria nënkupton që turizmi i qëndrueshëm përfshin përdorimin optimal të burimeve, duke përfshirë diversitetin biologjik; minimizimin e ndikimeve ekologjike, kulturore dhe sociale; dhe maksimizimi i përfitimeve për ruajtjen dhe komunitetet lokale. Ai gjithashtu i referohet strukturave drejtuese që nevojiten për ta arritur këtë. Për këtë arsye është më korrekte të flitet për turizëm të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm, pasi shpreh një mënyrë udhëtimi dhe zbulimi të vendeve të reja duke respektuar Planetin dhe vetë destinacionin. Natyrisht është e kundërta e turizmit masiv, një formë e turizmit të paqëndrueshëm pasi shkakton një ndikim të lartë në aspektin e ndotjes, mbi shfrytëzimit të natyrës dhe shqetësimit për

3 *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim*, 2015-2020, Maj 2016

4 <https://www.unwto.org/tourism-in-2030-agenda>

5 <https://www.unwto.org/>

6 <https://www.ecoluxury.com/it/discover-sdgs>



popullsinë vendase⁷. Pa dyshim këto tipare të qëndrueshmërisë (ekologjia, ekonomia dhe barazia) konsiderohen si thelbësore, por janë marrëdhëniet ndërmjet ekologjisë dhe ekonomisë, përkatësisht ekonomisë dhe barazisë, ato që përfaqësojnë pikat kyçe në çështjen e zhvillimit të qëndrueshëm. 8 Duke pasur parasysh se Shqipëria është shumë e pasur me zona natyrore të pa ndotura dhe për këtë arsye potencialisht shumë tërheqëse për lloje të ndryshme të udhëtarëve.

Realitetet e gjelbra janë tashmë të shumta dhe të pranishme në shumë zona të globit, nga hotelet ekologjike të ndërtuara sipas parimeve të bio-arkitekturës me ndikim zero mjedisor, deri te vlerësimi i zinxhirëve të shkurtër të furnizimit dhe produkteve të bujqësisë organike lokale. Për të kuptuar se çfarë nënkuptohet me turizëm të qëndrueshëm, është e mundur të përdoret përkufizimi i propozuar nga UNËTO, Organizata Botërore e Turizmit. Sipas agjencisë së Kombeve të Bashkuara, ku cilësohet që ky është turizmi i vetëdijshëm për ndikimin e tij social, ekonomik dhe mjedisor aktual dhe të ardhshëm, i aftë për të kënaqur nevojat e vizitorëve, komuniteteve lokale, mjedisit dhe kompanive. Pra, turizmi i qëndrueshëm ka tre aspekte të ndërlidhura: mjedisore, socio-kulturore dhe ekonomike. Objektivi⁸ i Agjendës 2030 «Puna e denjë dhe rritja ekonomike» merr këto udhëzime dhe i referohet qartë «konceptimit dhe zbatimit të politikave deri në vitin 2030 për të inkurajuar turizmin e qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet lokale».⁹

Transformimi i turizmit: dy hapa përpara, një e gjysmë prapa

Për më shumë se 40 vjet, OJF-të në të gjithë botën kanë bërë përpjekje për të bërë të mundur që zëri i njerëzve të varfër dhe të marginalizuar të dëgjohet në turizmin e globalizuar. Që nga viti 1999, kur turizmi ishte në agjendën e sesionit të 7-të të Komisionit të OKB-së për Zhvillimin e

Qëndrueshëm (UN-CSD) në Nju Jork, deri në formulimin e SDG-ve dhe Agjendës 2030, OJF-të kanë ngritur çështje dhe sfida.

Megjithatë, progresi i bërë nuk reflektohet as në pjesën më të madhe të ofertave turistike ndërkombëtare dhe as në tendencat në lidhje me përdorimin e burimeve në turizëm. Çështjet thelbësore lidhen me mënyrat se si zhvillohet turizmi gjatë gjithë ciklit jetësor të një destinacioni. Nuk është për t'u habitur që një numër i çështjeve që OJF-të kanë ngritur janë adresuar vetëm pjesërisht. Por ndërsa shumica e sfidave kanë mbetur, kushtet në të cilat ndodh turizmi kanë ndryshuar. Interneti dhe teknologjitë e tjera të informacionit kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrat në të cilat organizohet turizmi. Ndryshimet në financim, pronësi dhe strukturat e korporatave të kombinuara me kontraktimet në shkallë të gjerë, e kanë bërë më të lehtë për vendimmarrësit që të mbulojnë përgjegjësitë e tyre. Zhvillimet globale kanë ndryshuar flukset e kapitalit dhe flukset e turistëve¹⁰.

Turizmi është një nga industritë më të mëdha në botë dhe një nga sektorët me rritje më të shpejtë. Për shumë vende turizmi shihet si një instrument kryesor për zhvillimin rajonal, pasi stimulon aktivitete të reja ekonomike. Por rritja e paplanifikuar dhe e pakontrolluar e turizmit mund të rezultojë në një përkeqësim të tillë të mjedisit sa që rritja turistike mund të rrezikohet. Mjedisi, duke qenë burimi kryesor i produktit turistik, duhet të mbrohet për të pasur rritje të mëtejshme të turizmit dhe zhvillim ekonomik në të ardhmen. Kjo është veçanërisht e vërtetë për turizmin e bazuar në mjedisin natyror si dhe në trashëgiminë historiko-kulturore.¹¹

Përfshirja specifike e turizmit në agjendën e vitit 2030, është një njohje e rëndësisë globale të sektorit; por në të njëjtën kohë krijon një detyrim për të transformuar modelin aktual të biznesit të konsumit, i cili është i papajtueshëm me zhvillimin e qëndrueshëm.

Lind natyrshëm pyetja: a janë 17 Objektivat

10 *Transformimi i Turizmit, Turizmi në Agjendën 2030*, Mechtild Maurer ECPAT Deutschland e.V. Berlin, March 2017, fq 6.

11 Salvo Creaco, *The role of tourism in sustainable economic development*, 43rd Congress of the European Regional Science Association, 27 August – 30 August, 2003 Jyväskylä, Finland.

7 <https://www.sorgenia.it/guida-energia/turismo-sostenibile>

8 B. Farrel, Runyan. *Ecology and Tourism*, University of California, USA, 1991.

9 <https://albania.un.org/sq/sdgs/8>



e Zhvillimit të Qëndrueshëm mjaftueshëm ambicioze? Disa objektiva dhe tregues për progresin, mbeten të paqarta ose të pamjaftueshme; të tjerët, duke përfshirë treguesit e lidhur me turizmin, janë fokusuar në mënyrë të padrejtë në një paradigme rritjeje të rregulluar keq dhe kontradiktore. Kompleksiteti dhe ndërvarësia e Agjendës 2030, na kujton se mund të jemi ambicioz, të ndershëm, të qartë, krijues dhe transformues. Si një industri transversale, turizmi ka efekte të mëdha në jetën e përditshme të njerëzve vendas, komuniteteve dhe punëtorëve, si dhe ndikon në mjedisin dhe kulturën e tyre, dhe për këtë arsye ka një përgjegjësi të madhe¹².

Tre nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) përfshijnë në mënyrë specifike turizmin: Konceptimi dhe zbatimi deri në vitin 2030 i politikave për të promovuar turizmin e qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet lokale (SDG 8.9)¹³. Me specifikisht rezulton se synimi 8.9, vijon me dy nënsynime vijuese:

8.9.1 PBB e drejtpërdrejtë e turizmit në raport me PBB-në totale dhe në normën e rritjes

8.9.2. Numri i vendeve të punës në industrinë e turizmit në raport me totalin e vendeve të punës dhe norma e rritjes së vendeve të punës, sipas gjinisë.

Zhvillimi dhe zbatimi i mjeteve për monitorimin e ndikimeve të zhvillimit të qëndrueshëm për turizmin e qëndrueshëm, i cili krijon vende pune si dhe promovon kulturën dhe produktet lokale (SDG 12.8.b)¹⁴, Pra 12.b. 1 parashikon Numrin e strategjive apo politikave të turizmit të qëndrueshëm dhe planeve të veprimit të zbatuara me mjete të dakorduara monitorimi dhe vlerësimi.

Rritja e përfitimeve ekonomike të Shteteve të vogla ishullore në zhvillim dhe vendeve më pak të zhvilluara përmes përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve detare, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit, akuakulturës dhe turizmit (SDG 14.7)¹⁵.

12 *Dichiarazione di Berlino su "Trasformare il Turismo"*, Berlin, mars 2017.

13 <https://indicators.report/targets/8-9/>

14 <https://ocm.iccrom.org/sdgs/sdg-12-responsible-consumption-and-production/sdg-128-promote-universal-understanding>

15 <https://indicators.report/targets/14-7/>

Duke pasur parasysh detyrën shumë sfiduese të matjes së progresit në SDG, është e kuptueshme përdorimi i të dhënave dhe treguesve ekzistues. Megjithatë, për të matur ndikimin shumë të vlerësuar në zhvillim të turizmit, nevojitet një grup shumë më i gjerë treguesish socio-ekonomikë. Veçanërisht matja e "PBB-së së drejtpërdrejtë të turizmit si një raport ndaj PBB-së totale dhe normës së rritjes" është një udhë mashtruese. Qëndrueshmëria në turizëm duhet të matet kundrejt mënyrave në të cilat turizmi kontribuon në arritjen e SDG-ve, jo në shifra të kufizuara ekonomike.

Turizmi i qëndrueshëm i parashikuar në agjendën e vitit 2030, si term kontestohet ashpër nga organizatat e shoqërisë civile për mungesën e një qasjeje të përqëndruar tek njerëzit. Vetëm turizmi që kontribuon në përmirësimin e mirëqenies së popullsisë vendase, dinjitetin e punëtorëve, integritetin mjedisor dhe eliminimin e shfrytëzimit, pabarazive dhe varfërisë, është një opsion i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm. Nëse e shpërfillim këtë përgjegjësi, do keni një kërcënim për zhvillimin, dhe jo një mjet. Prandaj, zhvillimi i turizmit nuk është në vetvete një qëllim përfundimtar: të gjitha përpjekjet duhet të përqendrohen në transformimin e turizmit¹⁶.

Efektet negative ndihen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shumica e popullsisë së botës. Duke zgjeruar pabarazitë ekzistuese, shfrytëzimin e fuqisë punëtore, zhvendosjen e komuniteteve, modifikimin e kulturave, varfërimin e burimeve natyrore dhe si pasojë kërcënon brezat e ardhshëm. Të drejtat e grave, fëmijëve, pakicave dhe popullsive indigjene janë veçanërisht të cenueshme në dinamikën aktuale të turizmit.

Turizmi në zona të veçanta të mbrojtura (SPA) është një fushë dinamike e kërkimit që kërkon ekuilibrin midis ndikimeve ekonomike, mjedisore dhe socio-kulturore. Që nga shpallja e parë e zonës së mbrojtur në 1864, zonat e mbrojtura globalisht janë bërë një çështje e rëndësishme në lidhje me dilemën mbrojtje/përdorim. Një e gjashta e sipërfaqes tokësore globale u shpall kohët e fundit si zona të mbrojtura¹⁷. Përveç kësaj, 93%

16 Po aty, fq 2.

17 Geldmann, J.; Manica, A.; Burgess, N.D.;



e vendeve të trashëgimisë natyrore ofrojnë aktivitete turistike dhe rekreative¹⁸. Prandaj, menaxhimi i turizmit bëhet më i rëndësishëm duke marrë parasysh madhësinë, përbërjen dhe shumëllojshmërinë e kategorive të menaxhimit të zonave të mbrojtura, ku ruajtja dhe balanca e përdorimit të qëndrueshëm varet nga konteksti. Në Bashkimin Evropian sektori i turizmit përfaqëson afërsisht 10% të PBB-së dhe Evropa përfaqëson destinacionin kryesor turistik në botë. Për të mbrojtur këtë trashëgimi dhe për të promovuar rimëkëmbjen e saj në periudhën pas pandemisë, në mars 2021 Parlamenti Evropian propozoi një strategji të re ndërhyrjeje. Eurodeputetët fillimisht po bëjnë thirrje për masa sigurie dhe parandalimi (për shembull, krijimi i një vule certifikimi higjienike të BE-së) për të rritur besimin e konsumatorëve në sektorin e turizmit. Pandemia ka orientuar preferencat e udhëtarëve drejt zgjedhjeve që janë më shumë në kontakt me natyrën dhe, për këtë arsye, kërkohet krijimi i një angazhimi formal për të zhvilluar forma më të qëndrueshme të turizmit, të aftë për të reduktuar ndikimin mjedisor të sektorit.

Në përfundim të samitit të turizmit G20 (maj 2021), Shtetet, në institucionet e tyre më të larta, konfirmuan angazhimin e tyre për të mbështetur turizmin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm duke nënshkruar Udhëzimet e Romës G20 për të Ardhmen e Turizmit. Me atë rast u shpreh “dëshira për të eksploruar forma të reja bashkëpunimi në fushën e ekonomisë kreative dhe inovacionit në mbështetje të turizmit”.

Ndërsa, në COP26, në nëntor 2020, u prezantua zyrtarisht Deklarata e Glasgout për Veprimin e Klimës në Turizëm, e promovuar nga UNWTO së bashku me Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) i cili ka për qëllim aktivizimin e bashkëpunimit midis operatorëve dhe atyre të përfshirë në sektorin e

turizmit, për të kontribuar në programin për të reduktuar emetimet deri në vitin 2030.

Ndërsa qeveritë dhe kompanitë e turizmit kanë qarqet e tyre globale, qoftë Organizata Botërore e Turizmit e OKB-së (UNËTO) ose Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit (ËTTC), organizatat e shoqërisë civile dhe OJQ-të përballen me vështirësi në gjetjen e pikave hyrëse për pozicionet e tyre. Ndryshe nga organizatat e tjera të Kombeve të Bashkuara, nuk ka një mekanizëm adekuat të pjesëmarrjes në UNËTO. Për më tepër, hapësira për ndërhyrje nga organizatat lokale në shumë destinacione turistike të reja po zvogëlohet.

Drejt një politike të qëndrueshme turistike.

Në turizëm, vijat ndarëse nuk shkojnë vetëm midis vendeve të pasura dhe të varfëra, por edhe midis njerëzve që kanë luksin të udhëtojnë si turistë dhe atyre që nuk kanë as një ditë pushimi nga puna, e lëre pastaj të shkojnë me pushime. Udhëheqësit botërorë janë zotuar të zhdukin varfërinë, të mbrojnë planetin dhe të sigurojnë paqe dhe prosperitet për të gjithë. SDG-të, së bashku me Marrëveshjen e Parisit për ndryshimet klimatike, përbëjnë udhërrëfyesin për një botë më të mirë dhe kornizën globale të bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm dhe dimensionet e lidhura ekonomike, sociale, mjedisore dhe të qeverisjes. BE-ja ka qenë një nga forcat shtytëse pas Agjendës së OKB-së 2030 dhe është plotësisht e përkushtuar për zbatimin e saj.

Por duhet të pranojmë se, deri më sot, pak vende kanë treguar vërtetë ndjeshmëri ndaj këtyre çështjeve. Disa destinacione kanë adoptuar akses të kufizuar në disa atraksione, si p.sh. rasti shumë i njohur i Machu Picchu, ku Qeveria Peruane filloi një politikë të kufizimit të hyrjes ditore në 2016 për të ruajtur rrënojat më të njohura të Inkasve në Amerikën e Jugut (kufiri ditor u vendos afërsisht 4400 bileta për një total prej 1.5 milion vizitorë në vit). Ndërkohë në Itali, me specifikisht Venecia, do të nisë një provë që përfshin rezervimin për të hyrë në qytet duke lëshuar një kod QR (me përjashtim të banorëve dhe të ftuarve në ambientet e akomodimit). Në

Coad, L.; Balmford, A. *A Global-Level Assessment of The Effectiveness of Protected Areas at Resisting Anthropogenic Pressures*. Proc. Natl. Acad. Sci. USA 2019, 116, 23209–23215.

¹⁸ Spenceley, A.; McCool, S.; Neosome, D.; Báez, A.; Barborak, J.R.; Blye, C.J.; Bricker, K.; Sigit Cahyadi, H.; Corrigan, K.; Halpenny, E.; et al. *Tourism in Protected and Conserved Areas amid The COVID-19 Pandemic*. Parks 2021, 27, 103–118.



këtë rast, nuk është vendosur një kufi numerik për aksesin, por synohet të veprohet me çmimet, duke rritur ato për udhëtarët ditorë, duke dekurajuar kështu udhëtimin ditor.

Drejt gjetjeve sa me të favorshme, rruga është ende e gjatë. Ndalimi i imponuar nga pandemia sigurisht që ka ndihmuar në këtë kuptim, duke u dhënë një moment pushimi atyre destinacioneve që po vuanin më shumë nga ndikimi i turizmit. Gjatë këtyre dy viteve, vëmendja ndaj temës së qëndrueshmërisë ka shënuar një rritje të ndjeshme, por dëshira për udhëtime nuk ka rënë.

Për sa i përket Shqipërisë, të gjithë jemi të vetëdijshëm që turizmi në Shqipëri ka përjetuar një rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit, kjo si rezultat i bukurive natyrore të vendit, pasurisë së trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe përpjekjeve të ndërmarra për të promovuar dhe trumbetuar industrinë turistike. Referuar statistikave nga burime zyrtare, Shqipëria së fundi është shndërruar në një destinacion tërheqës në Evropë e më gjerë për turistët e huaj. Referuar qëllimit që deklarojnë shtetasit e huaj, që vizitojnë Shqipërinë, rezulton se gjatë muajit të tretë të vitit 2024 kanë ardhur 537,885 “turistë”, që janë vizitorë që shpenzojnë më shumë se një natë brenda territorit shqiptar. Kemi një rritje të konsiderueshme të vizitorëve që vijnë për qëllime biznesi.

Më poshtë është tabela e vizitorëve të huaj sipas qëllimit të vizitës së tyre, që deklarojnë në pikat tona kufitare në dy vitet e fundit:

Në muajin e tretë të vitit numri i vizitorëve të huaj dhe vendas që kanë vizituar institucionet e kulturës, është rritur 106% më shumë se numri i vizitorëve në Mars 2023. Po ashtu dhe numri i vizitorëve në 3 mujorin e parë të vitit është 89% më shumë se e njëjta periudhë e vitit paraardhës. Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në Institucionet Kulturore për këtë muaj rezulton që janë përfituar rreth 14,065,370 Lek.

Të dhënat nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se gjatë muajit Mars 2024 janë 200,165 vizitorë vendas dhe të huaj që kanë vizituar zonat tona të mbrojtura, ose 60 % më shumë se viti paraardhës. Në tre muajt e parë të vitit, zonat e mbrojtura janë vizituar nga 524,088 vendas dhe të huaj, me një rritje prej 65% më shumë se tremujori i parë i vitit 2023. Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të ardhurat, për zonat ku vizitorët paguajnë, për muajin Mars 2024, llogaritet që është përfituar një vlerë prej 505,150 Lek.

Turizmi është kthyer në një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, duke u konsideruar në këtë mënyrë, si një ndër motorët kryesorë të zhvillimit dhe rritjes ekonomike të vendit.

Vendi ynë, nga ana tjetër, në përpjekje për të promovuar kudo, madje dhe në mediat ndërkombëtare, destinacionet turistike si dhe bukuritë natyrore me qëllimin për të shtuar numrin e turistëve, nuk vlerëson

Periudha	Mars 2023	Mars 2024	Ndryshimi në %	Janar– Mars 2023	Janar–Mars 2024	Ndryshimi në %
Gjithsej	384.028	564.975	47,1	1.070.564	1.535.113	43,4
Personale	372.090	540.205	45,2	1.042.609	1.489.124	42,8
Pushime, miq e të afërm. Të tjerë	354.429	512.990	44,7	993.464	1.423.466	43,3
Trajtime Shëndetësore	25	70	180,0	180	179	-0,6
Qëllime fetare	22	55	150,0	80	98	22,5
Tranzit	17.614	27.090	53,8	48.885	65.381	33,7
2.Biznes dhe profesionale	11.938	24.770	107,5	27.955	45.989	64,5

Tabela 1: Vizitorëve të huaj sipas qëllim të vizitës së tyre 1

1 <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/BULETINI-I-TUR-IZMIT-MARS-2024-1.pdf>



mjaftueshëm pasojat që ky promovim sjell. Tashmë Shqipëria është kthyer në një atraksion me çmime “loë cost” por me bukuri natyrore si në shumë vende të tjera të botës, të cilat hera herës janë të papërballueshme nga të gjithë, dhe për rrjedhojë Shqipëria është bërë opsioni më i mirë i mundshëm. Duke e kthyer turizmin në masiv dhe aspak të qëndrueshëm, i cili sjellë shumë pasoja për një vend të vogël dhe jo shumë të zhvilluar. Turizmi mund të ofrojë një kontribut të rëndësishëm në tre dimensionet të zhvillimit të qëndrueshëm: të krijojë vende pune, të gjenerojë mundësi tregtare për të njohur nevojat dhe për të mbështetur aktivitete turizmi, të krijojë kapacitetet e rëndësishme të cilat promovojnë përparësitë për ruajtjen mjedisore dhe larminë kulturore. Por, kushtet e pasigurisë që mbizotërojnë në nivel ndërkombëtar, në sferën politike dhe ekonomike, krijojnë sfida për zbatimin e Agjendës 2030 edhe në Shqipëri, si kudo. Në datat 7-9 mars 2023, përmes një programi të organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nën sloganin “Albania-All you need is here”, u promovuan ofertat turistike që synojnë turizmin gjithëvjeter dhe të qëndrueshëm. Ndërkohë, gjatë këtij viti me datat 8-9 prillit 2024 u zhvilluan dy aktivitete ndërkombëtare të cilat e vendosën Shqipërinë në qendër të zhvillimeve të turizmit evropian, si dhe të politikëbërjes në nivelin më të lartë të Organizatës Botërore të Turizmit për Evropën.

Çfarë pritët nga Agjenda 2030 dhe sfidat për Shqipërinë?

Në kuadër të Agjendës 2030 Qeveria Shqiptare me përmbushjen e OZHQ-ve synon që të arrijë disa objektiva, duke marrë shkas që mjedisi dhe ndryshimet klimaterike janë bërë tematikat kryesore, jo vetëm në nivel global, por dhe lokal. Prioritetet e qeverisë shqiptare në këto vitet e fundit kanë pasur synim rritjen e transparencës, llogaridhënien, kapërcimin e krizave, reformat në drejtësi, rritjen ekonomike, luftën ndaj korrupsionit dhe integrimin drejt BE-së. Edhe pse, sipas

raporteve të OKB-së, Shqipëria në raport me shtetet e tjera është vlerësuar pozitivisht gjatë këtyre viteve, ajo që vihet re është se është kthyer në një destinacion tërheqës me turizëm sezonal dhe masiv, jo cilësor dhe aspak të qëndrueshëm. Nga kjo pikëpamje zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm mbetet ende një sfidë shumë e madhe për vendin tonë.

Turizmi në Shqipëri ka rritur kontributin në ekonominë vendase, duke krijuar vende pune dhe tërhequr investime. Megjithatë, është i pa mohueshëm fakti që ka sfida si mungesa të integritetit të të dhënave statistikore dhe koordinimit ndërmjet ministrive, e cila bën të pamundur përcaktimin real të ndikimit që ky sektor ka pasur në vend, ndryshe nga çfarë pretendohet.

Një tjetër sfidë që del në pah për turizmin në Shqipëri është mungesa e produkteve turistike të diversifikuara, infrastruktura e papërshtatshme dhe kategorizimin e dobët të akomodimeve. Kjo bashkuar me një mungesë të burimeve njerëzore të kualifikuara, trajnimit të përshtatshëm të tyre, dhe pagave të ulëta të cilat ndikojnë në cilësinë e shërbimeve.

Ndërkohë edhe pse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përpiluar një strategji për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nuk ka transparencë mbi implementimin e saj. Jo vetëm, por me përfundim e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023, nuk kemi rezultate të matshme, por duket se Ministria ka bërë me dije se po hartohet edhe strategjia e re të turizmit 2024–2030, që do jetë gati brenda vitit 2024. Ajo që ka rëndësi është fakti që bashkë me Strategjinë e re të Turizmit 2024–2030, parashikohet dhe ngritja e sistemit elektronik të statistikave në turizëm që është një “kantier i madh pune” që do të mundësojë të dhëna të përditësuara dhe të aksesueshme në çdo kohë. Njëkohësisht është punuar edhe në drejtim të ndryshimeve ligjore, duke miratuar ndryshimet në Ligjin Nr. 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017; nr. 101/2018, datë 13.12.2018; nr. 30/2024, datë 4.4.2024. Duke i dhënë



formë Agjencisë Kombëtare të Turizmit, kategorizimit të strukturave akomoduese, si dhe duke përcaktuar masat e gjobave për shkeljet administrative. Duhet nënvizuar fakti se klasifikimi i strukturave nuk ka gjetur akoma zbatim. Edhe pse kanë kaluar vite nga miratimi i tij Kategorizimi i Strukturave Akomoduese është ende i pa finalizuar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndryshuar urdhrin që lidhet me mënyrën kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese duke u ndalur në dokumentet që duhet të paraqesin subjektet në fazën e aplikimit, procedurën e shqyrtimit dhe formati i certifikatës. Në nenin 8 ndryshimet përcaktojnë formatin dhe atë që përmban certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese.

Kështu, së pari përshin emërtesën e strukturës akomoduese; së dyti, adresën e strukturës akomoduese; së treti, kategorinë; së katërti, datën e lëshimit të certifikatës së kategorizimit dhe në fund nënshkrimin e ministrit ose të personit të autorizuar prej tij. Certifikata e kategorizimit gjenerohet online në sistemin e-Albania. Lloji i kategorisë së strukturës akomoduese, sipas certifikatës së kategorizimit, vendoset në hyrjen kryesore/fasadën e strukturës akomoduese. Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, i administruar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Standardet në turizëm janë thelbësore për cilësinë e shërbimit dhe produktit turistik që një vend mund të ofrojë. Siç përshkruhet më sipër, Shqipëria do të përfitonte nga standardet e turizmit dhe do të bëhej më konkurruese, do të vazhdonte të kishte rritje në turizëm dhe do të mbështeste krijimin e vendeve të punës.

Në një treg global, na duhet të veprojmë si profesionistë. Shqipëria ka mjaft shembuj suksesi mbi të cilat mund të mbështetet për një menaxhim të turizmit masiv apo politikave të qëndrueshme, siç janë vende të Evropës si Spanja, Kroacia, Italia që kanë vënë në zbatim modelet e tyre me sukses.

Por nga vlerësimi i të gjithë komponentëve, duket se zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri, është ende larg.

Përfundime

Qindra miliona turistë udhëtojnë çdo vit drejt destinacioneve në të gjithë globin dhe industria e turizmit është një forcë e madhe ekonomike. Turizmi është një fenomen global dhe si rrjedhojë ka ndikime pozitive dhe negative në planetin tonë dhe njerëzit. Pasi mund të forcojë komunitetet duke siguruar më shumë të ardhura, burime dhe infrastrukturë. Krijon norma më të larta punësimi, ndihmon në ruajtjen e kulturës dhe gjuhës dhe çon në më shumë mirëkuptim kulturor. Sikurse fatkeqësisht, mund të ndikojë në cilësinë e jetës në komunitetet lokale, të zvogëlojë burimet natyrore dhe të shkaktojë largimin e tyre. Pjesëmarrja e komuniteteve lokale është thelbësore për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në zhvillimin e turizmit. Por në praktikë është ende një koncept abstrakt.

Qeverisja qendrore dhe qasjet nga lart-poshtë mbizotërojnë në formulimin, planifikimin dhe vendimmarrjen e politikave. Zakonisht biznesi dominon përmes mekanizmave të tyre lobues. Rolet e komuniteteve lokale dhe mënyra se si opinionet e tyre përfshihen në të gjithë procesin e planifikimit dhe zhvillimit nuk janë ende shumë të qarta në nivel terreni, duke përfshirë rolin e qeverisjes vendore si aktorë kryesorë në arritjen e SDG-ve. Për të bërë përparim, duhet të ketë një qasje të bazuar në të drejtat. Pra, e drejta e bashkësive lokale për të marrë pjesë në nivele të ndryshme të zhvillimit duhet të vendoset me masa adekuate legislative.

Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm të pashfrytëzuar të zhvillimit të turizmit. Avantazhet dhe asetet e saj turistike përfshijnë një pozicion të favorshëm gjeografik afër Evropës me produkte dhe vende të ndryshme në një zonë relativisht të vogël. Atraksionet e Shqipërisë përfshijnë aksesin në tre vende historike dhe kulturore të UNESCO-s, kishat, manastiret dhe xhamitë, festivalet folklorike, muzikën dhe instrumentet vendase së bashku me kuzhinën e pasur dhe të larmishme, peizazhet romantike dhe bregdetin.



Për të pasur sukses në tregjet rajonale dhe globale të udhëtimit, industria e turizmit në Shqipëri duhet të rrisë konkurrencën e saj në fushat e destinacioneve të turizmit natyror, kulturor, dhe të biznesit duke e çuar kështu përpara industrinë e përgjithshme të turizmit.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme krijimi i mundësive të punësimit direkt dhe indirekt për të forcuar aftësinë turistike të Shqipërisë nëpërmjet sasisë dhe cilësisë së strukturave akomoduese. Për të ofruar dhe mbajtur shërbime me cilësi të lartë nevojitet një staf i trajnuar mirë që di të ofrojë shërbime me cilësi të lartë dhe t'u përgjigjet nevojave të klientit

Qeveria Shqiptare, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe autoritetet vendore duhet të përqëndrohen në hartimin dhe zbatimin e planeve të qëndrueshme për zhvillimin e turizmit. Kjo përfshin identifikimin e zonave të rrezikuara si dhe përcaktimin e numrit të turistëve që mund të priten në çdo zonë pa dëmtuar mjedisin dhe kulturën.

Njëkohësisht, qeveria duhet të vendosë mekanizma të rregullt për monitorimin dhe vlerësimin e impaktit të strategjive të turizmit. Raportimi i të dhënave dhe performancës së sektorit do të ndihmonte në transparencën dhe në identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për të përmirësuar qasjen ndaj turizmit.

Jo vetëm, por duhet përmirësuar dhe ndërtuar infrastrukturë e qëndrueshme dhe e përputhshme me karakteristikat natyrore dhe kulturore të destinacioneve.

Kompanitë turistike duhet të përdorin teknologjitë e informacionit për promovimin dhe menaxhimin e destinacioneve turistike. Kjo do të ndihmojë në arritjen e një audience më të gjerë dhe në ofrimin e informacionit të rëndësishëm për turistët. Nëpërmjet politikave si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me sektorin privat, duhet të investohet në zhvillimin e produkteve turistike të ndryshme, duke përfshirë turizmin natyror, kulturor, agrikulturor dhe atë sportiv. Kjo do të ndihmonte në zvogëlimin e përqëndrimit në disa zona të caktuara dhe do të shpërndante

më mirë përfitimet ekonomike dhe impaktin në të gjithë vendin.

Dhe pa dyshim është i rëndësishëm ndërgjegjësimi i turistëve dhe komunitetit në praktikën e qëndrueshme turistike, si dhe respektimi i mjedisit dhe kulturës së vendit.

Bibliografia

Dichiarazione di Berlino su “Trasformare il Turismo”, Berlin, mars 2017.

B. Farrel, Runyan. Ecology and Tourism, University of California, USA, 1991.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015- 2020, Maj 2016.

Sarah Gainsforth, Oltre il turismo. Esiste un turismo sostenibile? Eris, 2020.

Geldmann, J.; Manica, A.; Burgess, N.D.; Coad, L.; Balmford, A. A Global-Level Assessment of The Effectiveness of Protected Areas at Resisting Anthropogenic Pressures. Proc. Natl. Acad. Sci. USA 2019, 116, 23209–23215.

Salvo Creaco, The role of tourism in sustainable economic development, 43rd Congress of the European Regional Science Association, 27 August – 30 August, 2003 Jyväskylä, Finland.

Spenceley, A.; McCool, S.; Newsome, D.; Báez, A.; Barborak, J.R.; Blye, C.J.; Bricker, K.; Sigit Cahyadi, H.; Corrigan, K.; Halpenny, E.; et al. Tourism in Protected and Conserved Areas amid The COVID-19 Pandemic. Parks 2021.

Transformimi i Turizmit, Turizmi në axhendën 2030, Mechtild Maurer ECPAT Deutschland e.V. Berlin, March 2017.

Ligjin Nr. 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017; nr. 101/2018, datë 13.12.2018; nr. 30/2024, datë 4.4.2024.

Sitografia

<https://www.unëto.org/tourism-in-2030-agenda>

<https://www.ecoluxury.com/it/discover-sdgs>

<https://www.unwto.org/>

<https://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2024/03/Buletini-i-Turizmit-Mars-2024-1.pdf>

<https://albania.un.org/sq/sdgs/8>

